



Prishtinë, 05.09.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1587_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2269_12_21** i dt.01.12.2021;
- Ankesa e konsumatorit e datës **19.08.2022**;

në seancën e mbajtur më datë **05.09.2022** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Q.M, nga komuna e Prishtinës si e pazuar;
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2269_12_21, i datës 01.12.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 01.12.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2269_12_21 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori Q.M, brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së, për shkak të paraqitjes në gjendjen jo reale;
- Konsideron që nuk është faji i tij që njehsori nuk ka bërë matje;
- Konsumatori kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2269_12_21 i datës 01.09.2021.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 05.09.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është bazuar në gjendje reale, Bordi i ZRrE-së, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, një nga një dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën, ka gjetur se, ankesa e konsumatorit duhet të refuzohet si e pazuar. Sepse, Bordi me kujdes dhe ndërgjegje ka analizuar dhe çmuar të gjitha provat relevante, si në vijim: Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0829311 datë 07.03.2019; Procesverbali i protokollit të shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.Org.02.Nr.4462 datë 06.03.2021;



Korrigjimi nr. 97356DPR-90119202 datë 26.03.2021; Ankesa e konsumatorit ne KESCO datë 30.03.2021; Përgjigja e KESCO-s e datës 05.05.2021; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 24.05.2021; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK_V_2269_12_21, dhe ka gjetur se pretendimet e konsumatorit janë të pabazuara dhe vendimi i DMK-së mbetet në fuqi si i ligjshëm dhe i bazuar.

Bordi pas analizimit të të gjitha dëshmive të paraqitura nga ana e konsumatorit dhe të licencuarit KESCO, ka vërejtur se, fillimisht Me datë 07.03.2019 punëtorët e autorizuar të KEDS-it per ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 67272073 me gjendje TL= /// kWh dhe TU= /// kWh dhe kanë vendosur njehsorin e ri elektrik nr. 20021534 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh . Ekipet e KEDS-it kanë evidentuar ne procesverbal që njehsori elektrik ndërrohet sipas procesverbalit nr. 0712718 datë 06.03.2019. Me datë 06.03.2021 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 67272073 me gjendje të shpenzimeve TL= /// kWh dhe TU= /// kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori elektrik display-in e ka në prishje, njehsori elektrik LED diodën e ka në prishje, njehsori elektrik vulat (bllobat) i ka ne rregull si dhe nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka. Me datë 26.03.2021 Departamenti i faturimit ne KESCO përmes korrigjimit nr. 97356DPR-90119202, ka bërë korrigjimin plotësues në vlerë **+268.48€** për faturat e periudhës 09/2018 deri ne periudhën 02/2019 duke e ngarkuar konsumatorin me shpenzimet e periudhës se njëjtë 09/2019 deri 02/2020 me njehsorin e ri nr.20021534. Me datë 30.03.2021 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kontestuar korrigjimin shtese nr. 97356DPR-90119202 date 26.03.2021. Me datë 05.05.2021 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 0829311 datë 07.03.2019 dhe protokollin të shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.Org.02.Nr.4462 datë 06.03.2021. Me datë 24.05.2021 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet korrigjimi plotësuese nr. 97356DPR-90119202 date 26.03.2021.

Bordi gjeti se bazuar në analizën e listave te leximit dhe rrjedhën përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik si dhe njehsorin e ri elektrik konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore por që me njehsorin kontestues nr. 67272073 nga fillimi i vendosjes për matje lexuesi i KEDS-it ka evidentuar që nuk ka qasje në leximin e shpenzimeve përveç periudhave 03/07/2017 dhe 03/2018. Mos qasja në leximin e shpenzimeve përkatësisht pikës matëse është në kundërshtim me nenin 25 paragrafin 1 Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *1." Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji".* Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese si dhe me te hershme me njehsorin e vjetër elektrik nr. 67272073 konstatohet se konsumatori është faturuar vetëm me taksa, përveç periudhave 07/2017 dhe 03/2018 pra pa shpenzim kurse pas ndërrimit te njehsorit, pra nga periudha 03/2019 ka lexime dhe faturime te rregullta mujore.

ZRrE ka shqyrtuar korrigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar bazuar në procedurat dhe kodet në fuqi sipas së cilave në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës atëherë duhet të bëhen të gjitha korrigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit e që për konsumatorët familjar përfshin periudhën gjashtë mujore.

Bazuar në të gjitha analizat e bëra konstatohet se KESCO ka vepruar konform nenit 4.11.2 të Kodit të Matjes së Operatorit të Shpërndarjes ku thuhet se: Në rastin kur konstatohet se njehsori ka gabuar



100, nuk ka regjistruar fare, atëherë korrigjimi i energjisë elektrike do të bëhet sipas mesatares paraprake të shpenzimit të konsumatorit, gjithashtu te rastet e defektit të ndonjë sistemi matës (pa ndonjë ndërhyrje të qëllimshme) veprohet me mesatare duke zbritur shpenzimin e regjistruar dhe faturuar por që në rastin e konsumatorit njehsori elektrik nr. 67272073 nuk ka bërë fare regjistrim të energjisë elektrike andaj si rrjedhojë e kësaj nuk ka mundur që të zbritet energjia mesatare paraprake.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori Q.M në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 05.09.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit Q.M. dhe
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar